



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Investimet vetjake, të realizuara gjatë Procesit Tarifor 2022/2024, në sektorin e ujit në Kosovë

**Monitorimi i realizimit të investimeve kapitale nga burimet
vetjake të financimi (tarifat e shërbimeve) krahasuar me
BPRR 2022/2024 të miratuar nga ARR**



Përmbajtja

HYRJE	3
Përmbledhje ekzekutive	4
Investimet kapitale dhe kategorizimi i aseteve	5
Asetet infrastrukturore	5
Asetet jo infrastrukturore	5
Asetet infrastrukturore në përgjithësi përfshijnë.....	5
Asetet e tjera (kryesisht mbi tokë) klasifikohen si jo infrastrukturore që përfshijnë:.....	6
Investime kapitale mirëmbajtja kapitale e infrastrukturës	6
Investimet në përmirësimin e infrastrukturës	7
Investimet kapitale për asete jo infrastrukturore.....	7
Ndikimi i investimeve kapitale në tarifa.....	8
Planifikimi dhe realizimi i investimeve kapitale vetjake, sipas kategorive	10
Shërbimet e ujësjellësit	10
Shërbimet e ujërave të ndotura	12
Paraqitje grafike:.....	14
Konkluzione	16
Rekomandime	17

HYRJE

Investimet e ofruesve të shërbimeve, nga burimet vetjake të financimit, në sektorin e shërbimeve me ujë dhe ujëra të ndotura, paraqesin një rëndësi të veçantë për Rregullatorin dhe vetë sektorin e ujit. Investimet kapitale janë të mbuluara me tarifën e shërbimeve të “Procesit Tarifor 2022/2024, të cilat i kanë paguar konsumatorët për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura. Pjesa tjetër e investimeve materializohet në volumnin e “Bazës Rregullatorë të Aseteve”, e cila në vijim, iu kthehet ofruesve të shërbimeve përmes “Normës së kthimit në kapital”.

Prandaj, realizimi i këtyre investimeve është me rëndësi jetike, jo vetëm se konsumatorët i kanë paguar me tarifën e shërbimeve, por rëndësi ka kjo ekuivalencë edhe për nivelin e ofruar të shërbimeve.

Departamenti i Tarifave, i prirë nga rëndësia e realizimit të këtyre investimeve, ka hartuar plan të veprimit për monitorimin e realizimit të këtyre investimeve. Jo vetëm kaq Departamenti i Tarifave, e ka monitoruar këtë realizim projekt për projekt, duke e fituar fotografinë reale të zhvillimit dhe ecurisë së këtyre projekteve. Ky raport është punuar sipas “Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator”. Po ashtu, do theksuar se, të dhënat e vitit 2024 janë të marra nga ofruesit e shërbimeve, duke inspektuar investimet projekt për projekt nga Departamenti i Tarifave, sipas BPRR, të miratuar nga ARRU, por që për shkak të procedurave rregullatore, këto të dhëna nuk janë edhe audituar nga ekipi auditues . Ndërkaq të dhënat e viteve 2022 dhe 2023 janë të audituara.

Mos realizimi i investimeve kapitale do të ketë ndikim në proceset e ardhshme tarifore (2029/2031) sepse atëherë do të balancohen kundërvlerat e këtyre investimeve të paguara me tarifë dhe të pa realizuara. Sidoqoftë, vizitat në terren, dëshmuar se ofruesit e shërbimeve kanë përmirësuar cilësinë e planeve të biznesit, evidencat kontabël dhe raportimin tek autoriteti, edhe pse shoqërohen me mangësi të theksuara. Duhet theksuar se në raport nuk janë të përfshira investimet nga donacionet apo grantet sepse fokusi i këtij monitorimi është investimi nga burimet e vetëfinancimit investimet nga tarifën e paguara nga konsumatorët.

Përmbledhje ekzekutive

Përgjatë “Procesit Tarifor 2022/2024”, investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit, të planifikuara për ujë, gjithsej ishin 14,370,371.00 €, kurse të realizuara 13,140,393.00 €, ose 91.44 %. Për shërbimet e ujërave të ndotura, gjithsej investime kapitale vetjake, të planifikuara ishin 3,612,053 €, kurse të realizuara 1,882,467.00 €, ose vetëm 52.1%.

Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe ujëra të ndotura, Procesin Tarifor 2022/2024, të planifikuara ishin 17,982,424 €, kurse të realizuara 15,022,860.00 € ose 83.5 %.

- **KRU “Prishtina”** nuk përmbushë cakun e investimeve kapitale për ujë, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022/2024. Prej burimeve të financimit nga KRU gjithsej për ujë ishin planifikuar 4,455,300.00 €, prej të cilave u realizuan 1,670,395.90 € apo shprehur në përqindje 37.49 % të investimeve. Gjithsej për ujë dhe ujëra të ndotura të planifikuara ishin 5,570,800.00 €, kurse të realizuara ishin 1,981,582.93 €, apo 35.57 %.
- **KRU “Mitrovica”** nuk përmbushë cakun të investimeve kapitale të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022/2024. Për ujë ishin planifikuar 1,170,000.00 €, u realizuan 496,719.00 €, apo 47.90 %. Për ujëra të ndotura me BPRR ishin të planifikuara 450,000.00 € të realizuara ishin 21,868.00 €. Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej ujë dhe ujëra të ndotura u planifikuan 1,620,000.00 €, kurse u realizuan 518,586.40 €, apo 32.01 %;
- **KRU “Hidrodrini”** Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej KRU-ja ka planifikuar për ujë 1,986,900.00 €, prej të cilave ka realizuar 3,577,910.4 €, apo shprehur në përqindje 180.08 %. Gjithsej për ujë dhe ujëra të ndotura, u planifikuan 2,136,900.00 €, kurse u realizuan 4,156,909.00 € ose 194.53 %.
- **KRU “Hidroregjioni Jugor”** Gjatë procesit tarifor 2022/2024 KRU-ja kishte planifikuar investime, në vlerë prej 1,911,700 € për shërbimet e ujësjellësit, por i ka realizuar ato në vlerë prej 1,949,080.00 € apo 101.96 %. Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar, për ujë dhe ujëra të ndotura 2,502,700.00 €, prej të cilave ka realizuar 2,437,648.12 €, apo 97.40 % .
- **KRU “Gjakova”** Gjatë procesit tarifor 2022/2024, KRU-ja kishte planifikuar investime për shërbimet e ujësjellësit në vlerë prej 2,903,911.00 €, kurse i ka realizuar 2,907,361.60 €, apo 100.12 %. Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej KRU-ja për ujë dhe ujëra të ndotura, ka planifikuar 3,507,200.00 €, prej të cilave ka realizuar 2,987,003.00 €, apo shprehur 85.17 % të investimeve. Caku rregullator nuk u realizua.
- **KRU “Bifurkacioni”** Prej burimeve të financimit nga KRU, në total KRU-ja ka planifikuar 935,970 € për shërbimet e ujësjellësit prej të cilave ka realizuar 1,303,238.70 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 139.24 % të investimeve. Caku i përcaktuar rregullator është përmbushur, kurse për ujë dhe ujëra të ndotura ka planifikuar 1,291,898.0 prej të cilave ka realizuar 1,415,708.93 apo 109.58 %.
- **KRU “Hidromorava”** Gjatë procesit tarifor 2022/2024, KRU-ja kishte planifikuar investime për shërbimet e ujësjellësit në vlerë prej 1,006,590.00 €, kurse i ka realizuar 1,235,687.50,€

apo 122.76 %. Për ujëra të ndotura me BPRR, të planifikuara ishin 346,336.00 €, kurse të realizuara ishin 289,734.00 €, apo 83.66 %. Prej burimeve të financimit nga KRU, gjithsej ujë dhe ujëra të ndotura, KRU-ja ka planifikuar 1,352,926.00 € prej të cilave ka realizuar 1,525,422.00 €, apo shprehur në përqindje ka realizuar 112.75 % të investimeve. Caku i përcaktuar rregullator u realizua rreth 109%.

Investimet kapitale dhe kategorizimi i aseteve

Në industrinë e ujit dhe ujërave të ndotura bëhet një dallim për qëllime rregullatore ndërmjet:

Asetet infrastrukturore

Asetet që kanë një jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar dhe të cilat, nëse mirëmbahen në mënyrë adekuate, duke përfshirë zëvendësimin dhe riparimin e madh të komponentëve me kalimin e kohës (mirëmbajtja kapitale), mund të pritet të ofrojnë një nivel shërbimi për konsumatorët për një periudhë të pacaktuar. Këto asete nuk i nënshtrohen zhvlerësimit. Në vend të kësaj, një tarifë për rinovimin e infrastrukturës (TRI) ofrohet në kërkesat për të ardhura dhe llogaritë rregullatore për të përfaqësuar mirëmbajtjen kapitale të funksionalitetit të aseteve nga biznesi gjatë vitit. Pasi këto asete nuk janë subjekt i zhvlerësimit, vlera në BRRRA ruhet përjetësisht. Investimi në përmirësimin e rrjetit, duke përfshirë zgjerimin e rrjetit, përmirësimet në nivelet e shërbimit, përmirësimet në cilësi dhe mirëmbajtjen e kapitalit të akumuluar shtohet në BRRRA në vend që të barten si pjesë e TRI-së. Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) ofrojnë detaje të mëtejshme mbi procesin e rinovimit të infrastrukturës.

Asetet jo infrastrukturore

Asetet ku jetëgjatësia është e përcaktueshme dhe mund të pritet të nxjerrën nga përdorimi ose zëvendësohen në fund të jetëgjatësisë së tyre të pritshme. Këto asetet i nënshtrohen zhvlerësimit të kostos aktuale gjatë jetëgjatësisë së tyre të pritshme të dobishme. Asetet ku jetëgjatësia është e përcaktueshme dhe mund të pritet të nxjerrën nga përdorimi ose zëvendësohen në fund të jetëgjatësisë së tyre të pritshme. Këto asetet i nënshtrohen zhvlerësimit të kostos aktuale gjatë jetëgjatësisë së tyre të pritshme të dobishme.

Asetet infrastrukturore në përgjithësi përfshijnë:

- Sistemet nëntokësore të rrjeteve dhe kanalizimeve,
- Grumbullimin dhe llojet e tjera të rezervuarëve për ruajtjen e ujit të papërpunuar,
- Digat,
- Tubacionet e llumit,
- Informacionin në lidhje me asetet infrastrukturore, (p.sh. të dhënat e hetimeve zonale).

Asetet e tjera (kryesisht mbi tokë) klasifikohen si jo infrastrukturore që përfshijnë:

- Pikat e mbledhjes së ujit,
- Stacionet e pompimit,
- Impiantet e trajtimit,
- Puset,
- Tokën operationale,
- Zyrat,
- Depot,
- Punëtoritë,
- Pronat rezidenciale, të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet operationale,
- Tokën e mbajtur, për të mbrojtur cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm,
- Impiantet dhe makineritë,
- Automjetet,
- Tokën e pashfrytëzueshme,

Të gjitha asetet e tjera që nuk janë përmendur më sipër ose si infrastrukturë.

Investime kapitale mirëmbajtja kapitale e infrastrukturës

Industria e ujit dhe e ujërave të ndotura ka karakteristika që në masë të madhe e bëjnë të pavlefshëm përdorimin e zhvlerësimit, si përcaktues për shpenzimet e mirëmbajtjes kapitale të aseteve infrastrukturore për disa arsye:

- Asetet janë përgjithësisht me jetëgjatësi shumë të madhe, zakonisht më të gjatë se sa jeta e tyre kontabël. Kostoja aktuale e zëvendësimit të aseteve mund të jetë ndjeshëm më e lartë sesa kostoja fillestare e prokurimit, edhe pas llogaritjes së inflacionit.
- Jetëgjatësia e aseteve është kryesisht e papërcaktuar.
- Shumë asete janë plotësisht (financiarisht) të zhvlerësuara, por janë ende në funksion dhe kërkojnë mirëmbajtje kapitale për të ruajtur funksionalitetin e tyre.
- Asetet janë përgjithësisht të groposura dhe nuk janë të qasshme për inspektim për të përcaktuar jetëgjatësinë e mbetur.
- Zhvillimet teknologjike mund të çojnë në shpenzime për zëvendësim të aseteve që ndryshojnë ndjeshëm nga asetet e vjetra, edhe pas llogaritjes së inflacionit.

Për këto arsye, shumica e rregullatorëve të industrisë së ujit përdorin rinovimet e infrastrukturës duke llogaritur asetet e infrastrukturës së rrjetit¹.

Shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të infrastrukturës përkufizohen si shpenzimet që KRU do të priste zakonisht t'i kishte çdo vit për të ruajtur nivelin ekzistues (jo të përmirësuar) të funksionalitetit të aseteve të rrjetit. Tarifë për rinovimin e infrastrukturës (TRI), që pasqyron shpenzimet e pritura për rinovimet e infrastrukturës, llogaritet çdo vit dhe përfshihet në kërkesën për të ardhura. Kjo do të thotë që, në vend që të kufizohet shpenzimi për mirëmbajtje kapitale të aseteve infrastrukturore në atë që mund të përcaktohet nga një dispozitë për zhvlerësim, KRU-të duhet të përcaktojë shpenzimet e nevojshme për të ruajtur nivelin e shërbimit dhe këto shpenzime, në thelb, do të reflektohen në tarifat në të njëjtën mënyrë si shpenzimet operative.

TRI përfaqëson shpenzimet e nevojshme për të ruajtur nivelet bazë të shërbimit dhe nuk përfshin shpenzimet për përmirësimin e infrastrukturës, të cilat përkundrazi shtohen në bazën rregullatore të aseteve (BRRA). Përmirësimi i infrastrukturës përfshin shpenzimet e bëra për të mbuluar mospërputhjet historike të shpenzimeve për rinovimet e infrastrukturës, përmirësimin e cilësisë së ujit, nivelet e shërbimit dhe balancimin e kërkesë/ofertës (duke përfshirë zgjerimin e shërbimeve). Grantet kapitale dhe kontributet që i atribuohen rinovimeve të infrastrukturës nuk përfshihen në kërkesën për të ardhura.

Investimet në përmirësimin e infrastrukturës

Investimet në përmirësimin e infrastrukturës përfshijnë:

Zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit për të përmbyshur kërkesën në rritje për ujë dhe gjenerimin e ujërave të ndotura nga konsumatorët shtesë dhe rritjen e konsumit të ujit dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura nga konsumatorët ekzistues. Përmirësimet në rrjet për të ofruar një përmirësim të përhershëm të niveleve të shërbimit, p.sh. për të përmirësuar ose menaxhuar më mirë presionin në rrjet. Përmirësimet në rrjet për të ofruar një përmirësim të përhershëm të cilësisë së ujit- për të përmbyshur standardet aktuale ose të reja të cilësisë së ujit, p.sh. zëvendësimi i gypave prej plumbit me gypa MDPE. Investimet pa përfshirë grantet dhe kontributet kapitale, për përmirësimin/zgjerimin e infrastrukturës- shtohen në BRRA. Pasi këto investime të jenë realizuar, çdo mirëmbajtje kapitale pasuese e tyre - trajtohet si rinovim i infrastrukturës.

Investimet kapitale për asete jo infrastrukturore

Investimet kapitale në asete jo infrastrukturore pa përfshirë grantet bartën në BRRA-në jo infrastrukturore. Për qëllime të përcaktimit të tarifave, nuk është e nevojshme të bëhet dallim nëse një investim i tillë është për mirëmbajtje kapitale apo për përmirësim. Një dallim i tillë kërkohet për analizën e kërkesave dhe ende kërkohet në procesin e përcaktimit të tarifave.

Bazuar në analizën fillestare të BRRA-së fillestare në vitin 2008, jetëgjatësia mesatare e dobishme e aseteve jo infrastrukturore është përcaktuar në 35 vjet. Që nga viti 2009, BRRA jo-infrastrukturore i është nënshtruar zhvlerësimit me normën 1/35 në të gjitha përcaktimet e tarifave. Kjo normë zhvlerësimi do të zbatohet, përveç, nëse KRU-të mund të ofrojë dëshmi të qëndrueshme për të justifikuar një normë tjetër më të përshtatshme.

Komponenti jo-infrastrukturor i BRRAsë i nënshtrohet zhvlerësimit sipas kostos aktuale me metodën e bilancit në rënie. Vlera fillestare e BRRAsë i nënshtrohet zhvlerësimit për një vit të plotë. Investimet e reja konsiderohen të përfunduara në mes të vitit dhe i nënshtrohen zhvlerësimit prej 50% në vitin e realizimit. Vlera mbyllëse e BRRAsë është vlera fillestare plus shtesat, minus nxjerrja nga përdorimi dhe zhvlerësimi. BRRAsë mesatare për vitin (vlera fillestare plus vlera mbyllëse e pjesëtuar me dy) është baza për përcaktimin e kthimit nga BRRAsë.

Zhvlerësimi i kostos aktuale realizohet përmes rivlerësimit të BRRAsë me normën e inflacionit të IÇK-së në fund të çdo periudhe të kontrollit të çmimeve.

Ndikimi i investimeve kapitale në tarifa

Investimet në asete infrastrukture dhe jo infrastrukture kontribuojnë në kërkesën për të ardhura në mënyra të ndryshme. Mirëmbajtja e planifikuar kapitale e grupit të aseteve infrastrukture kalon plotësisht në BRRAsë, pasi që IÇK ka insistuar në zhvlerësim. Si rrjedhojë vlera e aseteve infrastrukture ruhet përjetësisht. Shpenzimet për përmirësimin e aseteve infrastrukture, zgjerimin/përforcimin për plotësimin e konsumit shtesë të ujit, përmirësimin e niveleve të shërbimit ose përmirësimin e cilësisë së ujit shtohen në BRRAsë dhe vlera e tij e shtuar ruhet përjetësisht. BRRAsë që përbëhet nga BRRAsë fillestar plus çdo përmirësim (pa zbritur zhvlerësimin) i nënshtrohet indeksimit me inflacion në secilën periudhë të rishikimit të tarifave. BRRAsë e indeksuar me inflacion i nënshtrohet një norme kthimi e cila bartet në kërkesën për të ardhura.

Mirëmbajtja e planifikuar kapitale e grupit të aseteve jo infrastrukture i nënshtrohet zhvlerësimit të kostos aktuale, që përfshihet në kërkesën për të ardhura. Shpenzimet faktike për investime kapitale në asete jo-infrastrukture (mirëmbajtje kapitale dhe përmirësim) shtohen në BRRAsë dhe indeksohen me inflacion në secilën periudhë të rishikimit të tarifave. BRRAsë e indeksuar me inflacion i nënshtrohet një norme kthimi e cila bartet në kërkesën për të ardhura.

Realizimi i cakut të investimeve në “Procesin Tarifor 2022/2024” shprehur në përqindje

Investimet kapitale nga burimet vetjake të financimit, për ujë, në Procesin Tarifor 2022/2024, ishin gjithsej të planifikuara 14,970,371.00 €, kurse u realizuan 13,140,393.00 €, apo 91.44 %. Investimet kapitale nga burimet vetjake të financimit, për ujëra të ndotura, në Procesin Tarifor 2022/2024, ishin gjithsej të planifikuara 3,612,053.00 €, kurse të realizuara ishin 1,882,467.00 €, apo 52.12 %. Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe ujëra të ndotura, në Procesin Tarifor 2022/2024 të planifikuara ishin 17,370,371.00 €, kurse të realizuara ishin 15,022,860.00 € ose 83.5 %. Caku i përcaktuar rregullator për investimet vetjake në sektor nuk është realizuar.

Tabela nr.1 Investimet e Planifikuara

KRU	Ujë	Ujëra të ndotura	Totali
Prishtina	4,455,300	1,115,500	5,570,800
Hidroregjioni-Jugor	1,911,700	591,000	2,502,700
Hidrodrini	1,986,900	150,000	2,136,900
Mitrovica	1,170,000	450,000	1,620,000
Gjakova	2,903,911	603,289	3,507,200
Bifurkacioni	935,970	355,928	1,291,898
Hidromorava	1,006,590	346,336	1,352,926
Totali	14,370,371	3,612,053	17,982,424

Tabela nr.2 Investimet e realizuara

KRU	Ujë	Ujëra të ndotura	Totali	Realizuar
Prishtina	1,670,396	311,187	1,981,583	35.57%
Hidroregjioni Jugor	1,949,080	488,568	2,437,648	97.40%
Hidrodrini	3,577,910	578,999	4,156,909	194.53%
Mitrovica	496,719	21,868	518,586	32.01%
Gjakova	2,907,362	79,641	2,987,003	85.17%
Bifurkacioni	1,303,239	112,470	1,415,709	109.58%
Hidromorava	1,235,688	289,734	1,525,422	112.75%
Totali	13,140,393	1,882,467	15,022,860	83.54%

Tablea nr.3 Norma e realizimit të investimeve shprehur në %

Investime Vetjake	Planifikuara	Realizuar	Përqindja
Ujë	14,370,371.00	13,140,393.00	91.40 %
Ujëra të ndotura	3,612,053.00	1,882,467.00	52.10 %
Totali	17,982,427.00	15,022,860.00	83.50 %

Planifikimi dhe realizimi i investimeve kapitale vetjake, sipas kategorive

Shërbimet e ujësjellësit

Gjatë procesit tarifor 2022/2024, gjithsej investime të planifikuara me BPRR 2022/2024 në infrastrukturë ishin 6,658,402.00 €, kurse të realizuara ishin 8,020,724.00 €. Në jo-infrastrukturë, të planifikuara me BPRR 2022/2024, ishin gjithsej 7,111,969.00 €, kurse të realizuara ishin 5,119,669.00 €. Gjithsej investime vetjake, të planifikuara me BPRR 2024 ishin 14,970,371.00 €, ndërsa, të realizuara ishin (infrastrukturë dhe jo-infrastrukturë) 13,370,371.00 €.

Tabela nr. 4 Realizimi i investimeve vetjake Infrastrukturë dhe jo infrastrukturë

Emërtimi	Të aprovuara me BPRR	Të realizuara nga sektori
Infrastrukturë	6,658,402.00	8,020,724.00
Jo Infrastrukturë	7,711,969.00	5,119,669.00
Totali	14,370,371.00	13,140,393.00

Investimet e kategorizuara, sipas kosto qendrave për shërbime të ujit duken kështu:

Në kosto qendrën “Resurse” të planifikuara me BPRR 2022/2024 ishin 2,357,700.00 €, ndërsa të realizuara ishin 2,261,737.00 €, apo 95.92 %.

Për kosto qendrën e “Distribuimit”, të planifikuara me BPRR 2022/2024- ishin 9,593,041 €, kurse të realizuara ishin 9,009,970.00 €, ose 93.92 % .

Për kosto qendrën “Aktivitete të Përbashkëta”, të planifikuara me BPRR 2022/2024, ishin 2,419,630.00 €, ndërsa të realizuara ishin 1,868,686.00 €, apo 77.23 %.

Gjithsej të planifikuara ishin 14,370,371.00 €, kurse të realizuara ishin 13,140,393.00 €, apo 91.44 %.

Tabela nr. 5 Realizimi i investimeve vetjake sipas kosto qendrave ujë

Emërtimi	Të aprovuara	Të realizuara nga sektori
Resurse	2,357,700.00	2,261,737.00
Shpërndarje	9,593,041.00	9,009,970.00
Aktivitetet e përbashkëta	2,419,630.00	1,868,686.00
Totali	14,370,371.00	13,140,393.00

Tabela nr. 6 Kategorizimi i investimeve vetjake për Ujë

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar	Vlera e realizuar
			Financuar nga KRU	Financuar nga KRU
Resurse dhe trajtim	Infrastrukturë	Përteritje	30,000	536,930
		Rritje	994,200	533,744
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	998,000	540,133
		Rritje	335,500	650,930
Distribuum	Infrastrukturë	Përteritje	4,897,802	4,859,792
		Rritje	736,400	2,090,257
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	2,629,242	348,914
		Rritje	1,329,597	1,711,007
Aktivite Biznesore	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	2,419,630	513,007
		Rritje	0	1,355,680
Totali			14,370,371	13,140,393

Shërbimet e ujërave të ndotura

U realizua kjo strukturë investimesh sipas kosto qendrave për shërbimet e ujërave të ndotura. Për shërbimet e ujërave të ndotura gjithsej investime të realizuara ishin 1,882,467.00 €, nga 3,612,053.00 € të planifikuara ose 52.11 %.

Për shërbimet e ujërave të ndotura gjithsej investime të realizuara:

Në infrastrukturë të planifikuara ishin 2,271,454.00 € kurse të realizuara ishin 1,284,805.00 € të planifikuara ose 56.56 %. Në jo infrastrukturë u planifikuan 1,340,599.00 €, kurse u realizuan 597,662.00 €, ose 44.58 %.

Tabela nr.7 Investimet në UN të realizuara në Infrastrukturë dhe Jo Infrastrukturë

Emërtimi	Të planifikuara	Të realizuara
Infrastrukturë-UN	2,271,454.00	1,284,805.00
Jo infrastrukturë- UN	1,340,599.00	597,662.00
Totali	3,612,053.00	1,882,467.00


Sipas kosto qendrave, është kjo strukturë:

- Grumbullimi u planifikuan 1,341,628.00, kurse u realizuan 630,136.00 të planifikuara €, ose 46.96 %
- Trajtimi i Ujërave të ndotura u planifikuan 20,000.00 € , u realizuan 907,708.00 investime vetjake, apo 4,538.54 %
- Trajtimi i llumit, u planifikuan 1,846,636.00 €, kurse u realizuan 1,498.00 €, apo 0.08 %
- Aktivitetet e përbashkëta- u planifikuan 403,789.00 € investime, kurse u realizuan 343,125.00.00 €, apo 84.97 % .


Tabela nr. 8 Kategorizimi i investimeve vetjake në ujëra të zeza, sipas kosto qendrave

Kategoria e investimeve kapitale			Vlera e planifikuar	Vlera e realizuar
			Financuar nga KRU	Financuar nga KRU
Grumbullim	Infrastrukturë	Përteritje	774,343	33,607
		Rritje	52,000	458,553
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	515,285	4,166
		Rritje	0	133,810
Trajtimi i ujërave të ndotura	Infrastrukturë	Përteritje	0	545,329
		Rritje	20,000	247,315
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	0	0
		Rritje	0	115,063
Trajtimi i Llumit	Infrastrukturë	Përteritje	1,425,111	0
		Rritje	0	0
	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	421,525	0
		Rritje	0	1,498
Aktivite Biznesore	Jo infrastrukturë	Mirëmbajtje	293,289	121,145
		Rritje	110,500	221,980
Totali			3,612,053	1,882,467

Paraqitje grafike:




Realizimi i investimeve të financuara nga KRU



Investimet e realizuara në vlerë financiare

Investimet vetjake, të realizuara gjatë Procesit Tarifor 2022/2024



Përqindja e realizimit të investimeve

Konkluzione

- Përmbushje e caktut të investimeve kapitale vetjake në sektor, të përcaktuara gjatë procesit tarifor 2022/2024, përmbushja është në masën 83.5 % .
- Përgjatë Procesit Tarifor 2022/2024, investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit për ujë, të planifikuara gjithsej ishin 14,970,371.00 €, kurse të realizuara 13,140,393.00 €, ose 91.40 %.
- Për shërbimet e ujërave të ndotura, gjithsej investime kapitale vetjake, të planifikuara ishin 3,612,053.00 €, kurse të realizuara 1,882,467.00 € ose vetëm 52.1 %.
- Gjithsej investime vetjake nga ofruesit e shërbimeve, për ujë dhe ujëra të ndotur, në procesin e referuar tarifor të planifikuara ishin 17,982,424.00 €, kurse të realizuara 15,022,860.00 €, ose 83.50 %.
- Ofruesit e shërbimeve kanë dështuar për ta sjellë në ARRU azhurnimin e “Listës së investimeve kapitale nga burimet vetjake të financimit”, pas ndërhyrjeve rregulluese nga Departamenti i Tarifave.
- Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit, ofruesit e shërbimeve, nuk i kanë realizuar sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve ka shumë rëndësi në nivelin e shërbimit, njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa.
- Në kategorinë e investimeve infrastrukturë e ujërave të ndotura, me mjetet vetjake të financimit, KRU-të nuk kanë bërë investime sipas planifikimeve, as në destinim dhe as në vlerë financiare, të përcaktuar nga miratimet rregullatore.
- Mos realizimi i investimeve kapitale, tek disa ofrues shërbimesh, ishte ndikuar nga vonesat në procedurat e prokurimit, kërkesave nga donatorët për ndërhyrje emergjente, problemet financiare, nga keq menaxhimi etj.
- Ka mangësi tek kontimi i shpenzimeve të ujërave të ndotura, rezultuar si shpenzime jo reflektuese.
- Dështon mbështetja e plotë në Planin e Menaxhimit të Aseteve (PMA), duke rezultuar me planifikim jo të mirë sipas prioriteteve të projekteve të investimeve kapitale njëherësh edhe arsyetimi i projekteve ka pasur mangësi.
- Ofruesit e shërbimeve dështojnë për të bërë Planifikim të Investimeve Afatgjata(PIA) përjashtimisht dy kompanive. Po ashtu edhe kjo e ka kufizuar burimin për një plan të mirë biznesi, rrjedhimisht, realizimin e investimeve sipas prioriteteve të mirëfillta profesionale.
- Ofruesit e shërbimeve kanë dështuar për të sjellë Plan Biznesi të njëjtë në ARRU, sikurse në NPMNP.
- Ofruesit e shërbimeve, dështuan që të kërkojnë nga ARRU aprovimin e ndryshimeve në projektet e aprovuara me BPRR.
- Ofruesit e shërbimeve nuk kishin zë të shpenzimeve për kontigjenca dhe nuk kishin të planifikuara financa për investime të pa planifikuara. Për gjithë këto mangësi, ARRU ka hezituuar për ta sanksionuar kompaninë dhe bartësit individualë të përgjegjësive.

Rekomandime

- Ofruesit e shërbimeve duhet që ta njëjtësojnë Planin e Biznesit të ARRU-së me atë të NPMNP-së.
- Ofruesit e shërbimeve duhet ta braktisin praktikën e mos dorëzimit në ARRU “Listën e Azhurnuar të Investimeve kapitale”, pas ndërhyrjeve rregullatore.
- Ofruesit e shërbimeve duhet që ta përmirësojnë cilësinë e Plan Biznesit, duke u mbështetur në Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe PIA;
- Për investimet e pa realizuara kapitale, gjatë viteve vijuese, në procesin e ardhshëm tarifor 2029-2031, ARRU do të ndërmerr veprime rregulluese sipas Rregullores Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë, si dhe në bazë të dokumenteve të ndryshimeve metodologjike, në procesin e aprovimit të tarifave të shërbimit.
- Rekomandojmë që KRU-të të jenë të vëmendshme që për shkak të procedurave të prokurimit, problemeve financiare, ndërrimeve të fundit të menaxhmentit, që të angazhohet, që këto të mos ndikojnë në mos realizimin e investimeve kapitale.
- Rekomandojmë KRU-të, që të angazhohen më shumë në finalizimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve, i cili pasqyron gjendjen reale të asetëve të kompanive.
- Rekomandojmë KRU-të që të kenë koordinim më të mirë me komunën dhe donatorët e tjerë në mënyrë që planifikimet të bëhen me kohë dhe sipas prioriteteve dhe të përfshihen saktë në aplikacionin tarifor.
- Rekomandojmë KRU-të, që të bëjnë planifikim të saktë sipas prioriteteve, që shpijnë kah efienca më e mirë dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit, duke evidentuar humbjet e dukshme dhe duke adresuar ato. Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve, që të jenë të vëmendshëm që, investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit, t’i realizojnë sipas planifikimeve. Kjo kategori e investimeve, për ARRU, ka shumë rëndësi në nivelin e shërbimit njëherësh ka ndikim direkt edhe në tarifa. Praktika e deritanishme nuk do të tolerohet nga Autoriteti. Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që ta hartojnë “Planin e Investimeve Afatgjata” sa më parë që është e mundur.
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që, të mos bëjnë asnjë ndryshim të projekteve nga BPRR, pa aprovimin e Autoritetit.
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që të planifikojnë shpenzimet e kontigjencave;
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që në proceset e ardhshme tarifore të planifikojnë vlera financiare për projektet e pa planifikuara
- Rekomandojmë ofruesit e shërbimeve që t’i evitojnë këto mangësi, sepse Autoriteti do t’i ndërmerr veprimet, që kanë kundërvlerë efikasitetin, nivelin e shërbimeve, dhe veprime të tjera ligjore, etj.